



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr.551/10**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimiq dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

### **VENDIM**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK).

### **ARSYETIMI**

Më datën 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AAK i cili kërkon anulimin e rezultateve zgjedhore dhe përsëritjen e zgjedhjeve në komunën e Drenasit dhe të Skenderajit për shkak të manipulimit masiv nga ana e subjektit politik PDK.

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë prove materiale.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

*3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë materiale, që do të shërbente si dëshmi rreth rastit në fjalë. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 551/2010 më datën 15.12.2010

